



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KRYESIA

Pogradec, më 07.07.2023

VENDIM

Nr.2, Datë 07/07/2023

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË KONSULTIMIT PUBLIK, PËR PROJEKT
VENDIMET:**

PËR DHËNIEN E DAKORTËSISË, PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR PUBLIC TË SIPËRFAQES PYJORE PREJ 0.32(ZERO PRESJE TRIDHJETE E DY) HA, E NDOSHUR NË EKONOMINË PYJORE BISHNICË (PJESA EKONOMIKE UJI I FTOHTË), PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE “ZGALLOI & ZGALLO 2 , NGA SHOQËRIA “AUTOVISION AL” SHPK ”

PËR DHËNIEN E DAKORTËSISË, PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR PUBLIC TË SIPËRFAQES PYJORE PREJ 0.994(ZERO PRESJE NËNTËQIND E NËNTËDHJETË E KATËR)HA, E NDODHUR NË EKONOMINË PYJORE BISHNICË (PJESA EKONOMIKE TALLË), PËR NDËRTIM HIDROCENTRALI “SHPELLA POSHTË II”, NGA SHOQËRIA “LIRIA ENERGJI” SHPK”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 18 dhe 54, të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe Rregullores së Këshillit Pogradec për “Konsultimin Publik” miratuar me VKB nr. 42, datë 05/03/2020, Kryesia e Këshillit, duke u bazuar në dispozitat ligjore të mësipërme dhe duke qënë se janë paraqitur për vendimarrje projekt vendime të cilat kërkojnë heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve pyjore , pas konsultimit me Kryetarët e Komisioneve dhe sekretariatit e Këshillit:

V E N D O S I:

1. Të kalojë në proces konsultimi publik propozimin e Bashkisë Pogradec për dhënie e dakortësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor me qëllim ndërtimin e Hidrocentraleve.

2. Për realizimin e procesit të konsultimit ngarkohen:
- | | |
|----------------------|---------|
| 2.1. Ilija Mani | Kryetar |
| 2.2. Silvana Bozdo | Anëtare |
| 2.3. Klajdi Gjona | Anëtar |
| 2.4. Besnik Xhyra | Anëtar |
| 2.5. Klea Topa | Anëtare |
| 2.6. Zhaneta Elezaj | Anëtare |
| 2.7. Ylli Kasmollari | Anëtar |
| 2.8. Jona Bojko | Anëtare |
| 2.9. Matilda Tollaku | Anëtare |
| 2.10. Kledi Lufo | Anëtar |
| 2.11. Arben Braho | Anëtar |
3. Grupi i mësipërm do të zbatojë procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Këshillit për Konsultimin publik dhe do të paraqesin rekomandimet e marra për tu shqyrtuar edhe kaluar në Këshillin e Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËR KRYESINË E KËSHILLIT

KRYETARE

Manjola KAMOLLI

